

L I G J
Nr.8230, datë 6.8.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8076, DATË 22.2.1996 "PËR BANKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8173, DATË 21.12.1996 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8076, DATË 22.2.1996 "PËR BANKËN E SHQIPËRISË""

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", në nenin 42, në pikat 1 dhe 2 bëhen këto ndryshime:

"1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga nëntë anëtarë:

- Governori i Bankës së Shqipërisë, kryetar i këshillit;
- zëvendësgovernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendëskryetar i këshillit;
- sekretari i Përgjithshëm i Këshillit;
- gjashtë anëtarë.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës miratohen nga Kuvendi Popullor, mbështetur në propozimet e bëra si më poshtë:

- a. Tre anëtarë propozohen nga Kuvendi Popullor;
- b. një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës;
- c. dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave;
- ç. një anëtar propozohet nga ministri i Financave;
- d. një anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës;
- e. një anëtar propozohet nga Governori.

Governatori dhe zëvendësgovernatori i Bankës së Shqipërisë propozohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe emërohen apo shkarkohen nga Presidenti i Republikës.

Sekretari i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë propozohet nga Governori dhe miratohet apo shkarkohet nga Këshilli i Ministrave."

Neni 2

Neni 49, pika 1 e ligjit të mësipërm, ndryshohet si vijon:

"1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pezullohen nga detyra, deri në miratimin nga Kuvendi Popullor, prej Këshillit Mbikëqyrës në qoftë se ata:

- a. janë në pamundësi për të shërbyer në Këshillin Mbikëqyrës sipas neneve 42 ose 58, paragrafi "1" i ligjit nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë";
- b. janë dënuar për vepër penale;
- c. janë në vështirësi financiare ose janë deklaruar të falimentuar dhe nuk kanë paguar borxhet;
- ç. janë pezulluar ose janë larguar nga detyra që kanë pasur dhe për të cilën janë propozuar anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës nga organi përkatës, sipas përcaktimeve të nenit 42 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij.

Shpallur me dekretin nr.1871, datë 11.8.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep

Meidani